



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

### SESIONI I

(I DETYRUAR)

#### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

#### VARIANTI B

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja - seksioni dygjuhësh

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Migjeni****Studenti në shtëpi**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë

**Pyetja 8**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Figura e babait të Nushit vjen e ashpër, e ftohtë, e vrazhdë, me autoritet të palëkundur, me mendësi të prapambetur, krijon frikë dhe jo dashuri.
- Këto tipare janë theksuar për të treguar më qartë hendekun midis dy botëve, dy mënyrave të ndryshme të të menduarit, por edhe sa i vështirë është ndryshimi.

Ose

Këto tipare janë theksuar që të dalë më në pah bota e prapambetur, pasojat që ka në jetën e njerëzve dhe mënyrën e tyre të të menduarit.

Ose

Këto tipare janë të theksuar për të nxjerrë më në pah mjedisin mbytës dhe konservator të kohës, që pak shpresa jep për ndryshim.

**1 pikë**                      Nëse përcakton disa tipare të babait të Nushit.

**1 pikë**                      Nëse tregon se pse janë theksuar pikërisht këto tipare.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 9**                      **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Motra e Nushit është një personazh tepër tërheqës dhe dallon nga mjedisi ku jeton. Është gazmore, e hedhur, ka energjinë e rinisë dhe kontraston me mjedisin ku ajo jeton. Ka dëshirë të jetë ndryshe edhe pse kjo është e pamundur për shkak të rrethanave ku ajo ndodhet. Vajza është e etur për të renë dhe gjithçka ndryshe nga mjedisi ku jeton.

*Ndryshimi me nënën* e saj qëndron në faktin se kjo e fundit është më e nënshtruar, është thuajse hije në shtëpi, pa zë, e trembur. Agia është e qeshur, ndërsa nëna e ngurosur.

- b) Nushin e afron dashuria se e ka baba, por e largon mënyra e të menduarit. Nushi është përfaqësues i së resë, i ati i së vjetrës. Është një raport dashuri-urrejtje.

- 1 pikë** Nëse tregon se çfarë e bën të veçantë personazhin e Ages.
- 1 pikë** Nëse tregon dallimin e saj nga e ëma.
- 1 pikë** Nëse tregon se çfarë e afron dhe largon Nushin nga i ati.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 10                    4 pikë

### Model përgjigjeje

Momente ku Migjeni shfaqet vlerësues dhe komentues i situatave:

- Migjeni komenton raportin që Nushi ka me të atin dhe arsyet se pse pikërisht ky raport. Migjeni komenton pse Nushi e justifikon të atin (*rrethanat dhe shoqnia e krijuen, ndoshta jeta e ka bamë këtë njeri kaq të rreptë*).
- Migjeni nuk është vëzhgues i thjeshtë i situatave, por edhe ndërhyr vetë në to, të shfaqë mendimet e tij në lidhje me shoqërinë dhe të japë analiza gati sociologjike. Nushi nuk e shikon të atin në distancë, pasi ai është i shkolluar, ndaj përpiqet ta kuptojë dhe të shpjegojë (përmes tij dhe autori) se pse i ati sillet në këtë mënyrë.  
Ose  
Autori trajton raportin midis brezave dhe vlerëson të renë.

b) *Situata është paradoksale*, pasi nga njëra anë është familja tipike patriarkale dhe në anën tjetër është pikërisht kjo familje që duhet të jetë gati për të ardhmen. Pra, kemi pranëvënien e dy botëve. ***Ironia qëndron në nëntekst***: një familje e tillë kaq e mbyllur, kaq arkaike, si mund të jetë familja qytetare e së nesërme? Pra edhe e nesërmja rrezikon të jetë po si kjo familje, ku ndryshimi është i pamundur për shkak të shumë rrethanave.

Ose

Paradoksi qëndron në kontrastin mes njeriut që “edukohet” në këtë familje dhe asaj çfarë pret shoqëria për të nesërmen.

Ironia qëndron në faktin se një familje e tillë nuk ka se ç’i ofron jetës qytetare, por priret ta bëjë atë si vetja.

- 1 pikë** Nëse gjen një rast në fragment ku Migjeni shfaqet vlerësues apo komentues.
- 1 pikë** Nëse shpreh një mendim personal në lidhje me këtë pozicionim të Migjenit.
- 1 pikë** Nëse shpjegon situatën paradoksale.
- 1 pikë** Nëse shpjegon nëntekstin ironik
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

**Pyetja 11**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Patriarkalizmi shfaqet në mjedis dhe në mendësi. Disa nga momentet ku ai shfaqet dukshëm në këtë fragment janë:
- Në qendër të familjes është babai, fjala e të cili është ligj.
- Të gjithë i binden babait.
- Nënshtrimi i nënës së Nushit, që adhuron bashkëshortin dhe i bindet për çdo gjë.
- Mentaliteti i prapambetur i babait: të gjithë i binden pa kundërshtuar.
- E gjithë familja e mbyllur brenda mureve të shtëpisë.
- Martesa e motrës së Nushit pa e pyetur fare.
- Frika nga e reja dhe gjithçka që është ndryshe (motra e Nushit ka dëshirë të vallëzojë, të dalë të shëtisë)
- Vajza e mbyllur në shtëpi dhe nën urdhrat e babait.
- Frika ndaj kryetarit të shtëpisë.

**2 pikë**                      Nëse gjen dy momente ku shfaqet patriarkalizmi.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse gjen vetëm një moment ku shfaqet patriarkalizmi.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Pyetja 12**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

Nushi ndihet më mirë në vende të huaja, sepse:

- Jeta në ato vende është e lirë dhe e pakushtëzuar nga korniza mendësie dhe paragjykimi.
- Njerëzit e shijojnë jetën (vajzat që vallëzojnë, që dalin me djem).
- Vajzat nuk mbyllen në shtëpi
- Mënyra e ndryshme e të menduarit.
- Vende të arsimuara (Nushi studion jashtë)

**2 pikë**                      Nëse gjen dy arsye që shpjegojnë pse Nushi ndihet më mirë jashtë se në vendin e tij.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse gjen vetëm një arsye.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13**            **2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Folja: *ndëgjojnë*
- b) Përmes përsëritjes së kësaj foljeje autori ka dashur të theksojë nënshtrimin e një familjeje të tërë, pamundësinë për të komunikuar me kryetarin e familjes, bindjen e plotë ndaj tij.  
Ose  
Pjesëtarët e familjes *janë bamë veshë*. Për ta mendon vetëm ai, kryetari i familjes. Ata janë të depersonalizuar.

**1 pikë**            Nëse identifikon foljen.

**1 pikë**            Nëse shpjegon arsyen e përdorimit të dendur të saj.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**PJESA II****Pushkini****Eugjen Onjegjin**

<b>Pyetja 14</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 15</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 17</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 18</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 19</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 20**            **3 pikë****Model përgjigjeje****Vargjet janë:**

*Mendo: jam vetëm, s'kam ku flas,*

*Askush nuk mund të më kuptojë*

*Mendja fillon të më lëshojë,*

*Në heshtje duhet të humbas*

**Arsyeja e vetmisë:** ndjenja që e shpëput nga bota përreth, pakënaqësia ndaj ambientit dhe shpëputja brenda ndjenjës së saj. Ajo nuk kuptohet nga ambienti, pasi është e vetme në guximin e saj (ambientit s'e pranon këtë veprim dhe në këto kushte ajo s'mund t'i hapet kujt)

**Gjendja shpirtërore:** e tronditur, e trishtuar por me shpresë tek Onjegjini.

**1 pikë**            Nëse gjen vargjet ku Tatjana paraqet vetminë e saj.

**1 pikë**            Nëse gjen arsyen e kësaj vetmie.

**1 pikë**            Nëse përcakton gjendjen e saj shpirtërore.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21**      **4 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Raporti është antonimik: *ëngjëlli – lajkatar*  
Ose  
Raport kontrastues.
- b) Folja është: *besomëni*. Përmes shumësit tregon respekt, largësi dhe një farë përulje, lutje (toni lutës), etikë.
- c) Përdorimi i dendur i pyetjeve retorike përforcon shqetësimin shpirtëror të heroinës, luftën brenda vetes, dilemat që e trazojnë. Gjithashtu, tregon fuqinë e ndjenjës, blatimin pa kushte, etj.

**1 pikë**      Nëse tregon raportin kontekstual.

**1 pikë**      Nëse gjen foljen.

**1 pikë**      Nëse tregon se pse është përdorur në numrin shumës.

**1 pikë**      Nëse shpjegon arsyen e përdorimit të pyetjeve retorike në një numër jo të vogël.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22**      **3 pikë****Model përgjigjeje**

Tatjana është rritur në fshat, ajo është e lidhur me vendin e saj.

Vlerëson jetën e thjeshtë, por kupton se kjo thjeshtësi e largon Onjeginin, i cili vjen nga mjedise aristokrate të rafinuara.

Tatjana shpreh frikë dhe turp nga paragjykimi i shoqërisë. Ajo ndjen se mjedisi provincial, me zakonet dhe normat e tij, do të jetë i ashpër në qëndrimin që do të mbajë ndaj guximit të saj.

**1 pikë**      Nëse tregon raportin që Tatjana ka me mjedisin ku jeton.

**1 pikë**      Nëse tregon se çfarë vlerëson ajo nga ky mjedis.

**1 pikë**      Nëse tregon se çfarë qorton ajo nga ky mjedis.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

***Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.***

**Pyetja 23**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

Risitë janë:

- e thjeshtëzoi poetikën.
- bëri përshkrime realiste të natyrës dhe psikologjisë njerëzore.
- krijoi strofën 14 vargëshe ABAB, CCDD, EFFE, GG (onieginiane).
- me Pushkinin nisi realizmi në letërsinë ruse.
- solli figurën e vajzës së thjeshtë ruse (figura e Tatjanës konsiderohet më e spikatura në letërsinë ruse).
- për herë të parë në letërsinë ruse futi figurën e njeriut të zakonshëm, me sinqeritet e thjeshtësi.
- rinovoi gjuhën e letërsisë, shprehu botën shpirtërore të njerëzve që kërkonin çlirim nga tradita shekullore e fatkeqësive dhe shtypjes.
- për herë të parë solli në letërsi karakterin e pangatërrueshëm dhe shpirtin e pastër të njeriut rus (nga veshja, gjuha, deri te besimet, paragjykimet, besëtytnitë si dhe morali e idealet).

**2 pikë**                    Nëse gjen dy karakteristika të veprës së Pushkinit.**OSE****1 pikë**                    Nëse gjen vetëm një karakteristikë të veprës së Pushkinit.**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 24**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

Tatjana është në fund të letrës. Kjo mbyllje s'është e lehtë për të. Asaj i duhet të fitojë edhe një herë mbi opinionin, mbi atë sistem morali në të cilin ajo është rritur.

Por ajo e ka vendosur (*Mbarova!*) se do t'i shkojë deri në fund ndjenjës së saj. Tatjana shfaqet me plot besim në fisnikërinë e Onjeginit.

Gjendja e saj psikologjike është e ngarkuar emocionalisht: aty lufton arsyeja dhe ndjenja.

Ose

Guximi gati po e lë, ajo ka frikë veten, por gjithsesi ka besim te djali, fiton ndjenja.

**1 pikë**                    Nëse interpreton vargjet përmbyllëse.**1 pikë**                    Nëse shpjegon gjendjen psikologjike të Tatjanës në këtë moment.**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të saktë.*

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**    **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton fuqinë e dashurisë për t'u ngritur mbi mjedisin mbytës, provincial dhe paragjykses, por dhe për të triumfuar mbi vetveten.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**                      **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI**    **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**    **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.